



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.758/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Sh.R.” BI, me seli në Prishtinë Rr. ... nr. ..., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit Nr.07/4/6841 të datës 06/10/2017, jashtë seancës me datë 25.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “Sh.R.” BI, me seli në Prishtinë Rr. ... nr. ..., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë me çka ka kërkuar anulim të Vendimit Nr.07/4/6841 të datës 06/10/2017.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me datë 20.05.2021 paditësi “Sh.R.” BI, me seli në Prishtinë Rr. ... nr. ..., ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë me çka ka kërkuar anulim të Vendimit Nr.07/4/6841 të datës 06/10/2017.

Gjykata me datë 26.03.2024 Paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 28.03.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.758/22, datë 25.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.